Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

THIRRJE PËR APLIKIM - PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), në kuadër të projektit "Përmirësimi i qasjes në tregun e punës për grupet e cenueshme përmes përmirësimit të shërbimeve këshilluese të punësimit në Kosovë", me mbështetjen e Qeverisë Gjermane nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, shpall thirrjen për aplikim në Programin e Vetëpunësimit.

Programi synon të mbështesë personat e papunë në krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të qëndrueshme, duke kombinuar trajnimin për vetëpunësim, zhvillimin e planit të biznesit, mbështetjen financiare për fillimin e biznesit, mentorimin dhe monitorimin pas themelimit të tij. Programi zbatohet në përputhje me Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2018 për Masat Aktive të Tregut të Punës, në veçanti met nenet 25, 26, 27 dhe 28.

Në përputhje me objektivat e projektit "Përmirësimi i qasjes në tregun e punës për grupet e cenueshme përmes përmirësimit të shërbimeve këshilluese të punësimit në Kosovë", programi synon integrimin në tregun e punës të personave që përballen me barriera në punësim, përmes krijimit të mundësive për vetëpunësim dhe zhvillim të qëndrueshëm të biznesit.

Programi parashikon trajnimin e deri 160 **punëkërkuesve** dhe mbështetjen e **deri të 50 përfituesve me grante deri në 6000 euro,** me një buxhet total për këtë thirrje prej **150,000 Euro** .

Çfarë ofron Programi i Vetëpunësimit?

- trajnim për vetëpunësim;
- mbështetje në zhvillimin e një plani të biznesit;
- mundësi për përfitimin e një granti për fillimin e biznesit;
- mentorim dhe monitorim deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

Kush mund të aplikojë?

- Të papunët e regjistruar në Zyrat e Punësimit të APRK-së: Të cilët kanë një ide për krijimin e një biznesi dhe janë të gatshëm të angazhohen personalisht dhe drejtpërdrejt në zhvillimin dhe funksionimin e biznesit.
- Personat e moshës **22 vjeç e lart;**
- Gratë;
- Minoritetet pakicë;
- Personat me aftësi të kufizuar dhe
- NEET (personat që nuk janë të punësuar, nuk vijojnë shkollim, dhe nuk ndjekin trajnime profesionale).

Sektorët prioritarë

- Përpunimit dhe paketimit të ushqimit;
- Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
- Ofrimit të shërbimeve në ndërtimtari;
- Përpunimit të metaleve;
- Përpunimit të tekstilit;
- Përpunimit të drurit dhe bizneset pyjore jo-drunore;
- Ekonomia dhe industritë kreative, duke përfshirë dizajnin grafik, animacionin, produksionin multimedial, dizajnin e modës dhe shërbimet e bukurisë;
- Prodhimi dhe përpunimi artizanal, përfshirë prodhimin e produkteve artizanale dhe suvenireve.

Vëmendje: Aplikimi në një sektor prioritar nuk garanton përzgjedhjen përfundimtare, pasi të gjitha aplikimet i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

Sektorët dhe aktivitetet që nuk mbështeten

- bujqësinë primare dhe blegtorinë;
- pasuritë e paluajtshme dhe qiranë;
- ndërtimin e lartë dhe infrastrukturor;
- operacionet financiare, sigurimet dhe lojërat e fatit;
- prodhimin e pijeve me përmbajtje të lartë alkooli;
- prodhimin e duhanit dhe armëve;
- aktivitetet prodhuese që shkaktojnë ndotje të mjedisit;
- bizneset joformale dhe aktivitetet në sektorët e tregtisë.

Procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes

1) Ideja fillestare për biznes: Kandidati aplikon me idenë fillestare në Zyrën përkatëse të Punësimit dhe online.

2) Shqyrtimi, Vlerësimi i aplikacionit dhe idesë fillestare të biznesit: Idetë shqyrtohen nga Paneli Vlerësues i APRK-së dhe vetëm kandidatët që kalojnë këtë fazë mund të vazhdojnë të ndjekin trajnimin për vetëpunësim.

3) Ftesa për trajnim: Aplikantët e përzgjedhur me idenë më të mirë të biznesit përmes thirrjes publike ftohen për të marrë pjesë në trajnimin 'Fillo biznesin tuaj' në Qendrat e Aftësimit Profesional në rajonin e tyre.

4) Trajnimi për vetëpunësim dhe zhvillimin e planit të biznesit: Pas trajnimit secili aplikant i nënshtrohet testit përfundimtar dhe ata që përfundojnë testin me sukses, ftohen që të dorëzojnë planin e tyre të biznesit.

5) Dorëzimi dhe vlerësimi i planit të biznesit: Pasi që plani i biznesit dorëzohet nga aplikantët në Zyrat e Punësimit, bëhet vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit nga një panel i themeluar nga APRK-ja në përbërje prej 5 anëtarësh në afat prej 30 ditësh.

6) Intervista/Prezantimi i idesë dhe vlerësimi përfundimtar për grant: Kandidatët e suksesshëm ftohen në intervistë dhe më pas bëhet vlerësimi përfundimtar i planit më të suksesshëm. Pas përfundimit të vlerësimit shpallet lista përfundimtare e rezultateve. Përfituesit nga lista përfundimtare e rezultateve nënshkruajnë kontratën për grantin që përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në zbatimin e grantit.

7) Regjistrimi i Biznesit: Përfituesi i grantit në afat prej 30 ditësh duhet të regjistrojë biznesin dhe të pajiset me certifikatën e biznesit apo të gjenerojë numër fiskal.

Mbështetja financiare

Aplikantët e përzgjedhur mund të përfitojnë grant deri në 6000 Euro për fillimin e biznesit.

Granti përdoret vetëm për zbatimin e Planit të Biznesit të miratuar.

- materiale për renovim të lokalit (jo më shumë se 20% e grantit);
- blerjen e makinerive dhe pajisjeve;
- blerjen e programeve/software-it;
- lëndë të para dhe materiale shpenzuese;
- promovim dhe reklamim.

Të gjitha shpenzimet duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me biznesin e aprovuar dhe të realizohen në përputhje me kushtet e Rregullores, Manualit dhe kontratës së grantit.

Shpenzimet që nuk mbulohen për Grant janë:

- blerjen e tokës, ndërtesave ose pasurive të tjera të paluajtshme;
- blerjen e automjeteve;
- shpenzime që nuk lidhen me biznesin e propozuar;
- shpenzime të kryera para nënshkrimit të kontratës së grantit;
- blerjen e pajisjeve ose makinerive të përdorura;
- Pagat e punëtorëve.

Shërbimet e mentorimit, monitorimit dhe mbështetja pas grantit

Përfituesit e grantit do të kenë mundësi të përfitojnë mentorim, monitorim dhe mbështetje profesionale për një periudhë deri në 12 muaj, me qëllim lehtësimin e fazës fillestare të zhvillimit të biznesit, rritjen e

kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale, si dhe promovimin e qëndrueshmërisë dhe suksesit afatgjatë të biznesit.

Vërejtje: I papunësuari i regjistruar që përfiton grantin nuk ka të drejtë të aplikojë për përfitim nga kjo masë apo nga masat e tjera përkatëse të punësimit për një periudhë prej 36 muajsh.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Formulari i plotësuar për aplikim me ide biznesi (një origjinal + tre kopje në gjuhën zyrtare)
- Deklarata e Papunësisë
- Deklaratën e Pëlqimit dhe;
- Dokumentet që dëshmojnë nivelin e arsimimit, kualifikimet dhe përvojën profesionale.

Si të aplikoni?

Aplikimi bëhet në formë fizike në Zyrën e Punësimit ku kandidati është i regjistruar. Çdo aplikant mund të aplikojë me vetëm një ide biznesi.

Afati i aplikimit: Aplikimet pranohen nga: 16.11.2026 deri më 30.11.2026 (ora 16:00). Aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen.